




Pranuar / Dorezuar Prilježen / Predato Received / Delivered	17-11	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKUPŠTINA	7206/2022		116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.815/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.815/2022 të datës 21.09.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë:

[redacted] kundër organit të punësimit Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.11.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.815/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] ka qenë i sistemuar në pozitën "Zyrtar Ligjor" në Prokurorinë Themelore në Gjakovë-Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas Akt-it të emërimit me numër protokolli ZBNJ/DP-488/2015 të datës 08.10.2015, ndërsa Administratorja në Prokurorinë Themelore në Gjakovë përmes kërkesës me numër protokolli 850 të datës 17.05.2018, ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit

Pas marrjes së kërkesës për inicim të procedurës disiplinore Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 08.06.2018 merr Vendim me numër KD.nr.02/2018, me të cilin vendim ankuesit [redacted] i shqiptohet masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës, pa i dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension".

Ankuesi kundër vendimit të Komisionit Disiplinor me datë 22.06.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 17.07.2018 merr Vendim me numër KA.nr.49/2018, me të cilin vendim i refuzon si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lenë në fuqi Vendimin KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër KA.nr.49/2018, të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 17.08.2018 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.10.2018 merr Vendim me numër A.nr.535/2018, me të cilin vendim e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën me numër A.nr.535/2018 të datës 17.08.2018 duke shfuqizuar Vendimin KA.Nr.49/2018 e datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimin me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës i pa kënaqur me Vendimin e Këshillit ka parashtruar kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit me numër A.Nr.535/2018 të datës 15.10.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktvendimin A.nr. 2527/2018 të datës 29.10.2018 ka aprovuar si të bazuar kërkesën e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.535/2018 të datës 15.10.2018 deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, duke vepruar sipas padisë së paditësit-Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 14.04.2021 nxjerrë Aktgjykimin A.nr.2527/2018, me të cilin refuzohet kërkesë padia e paditësit Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe e vërteton vendimin me numër A.nr.535/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës i pa kënaqur me Aktgjykimin Anr.2527/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 18.05.2021 parashtron ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrativ, e cila me Aktgjykimin me numër AA.nr.503/2021 të datës 31.05.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 18.05.2021 si dhe anulon Aktgjykimin A.Nr.2527/2018 të datës 14.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative si dhe Vendimin me numër A.nr.535/2018 të datës 15.10.2018 të

Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështja i kthehet organit të paditur në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit AA.Nr.503/2021 të datës 31.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, dhe pasi ka rishqyrtuar provat e lëndës me datë 13.07.2022 merr Vendim me numër A.nr.528/2022, me të cilin vendim e ka aprovuar si të bazuar ankesën me numër A.nr.535/2018 të datës 17.08.2018, duke anuluar Vendimin KA.Nr.49/2018 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimin me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe çështjen e kthehen në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës duke vepruar sipas Vendimit me numër A.nr.528/2022 të datës 13.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.08.2022 merr Vendim me numër KD.Nr.04/2022, me të cilin vendim Komisioni disiplinor shpallet jo kompetent për vendosje ne procedure disiplinore ndaj [redacted] ish zyrtar ligjor ne në Prokurorinë Themelore në Gjakove .

Ankuesi [redacted] me datë 19.09.2022 përmes emailit zyrtar: ankes.KPMSHCK@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores, me propozimin që Komisioni të anuloi vendimin duke pushuar procedurën disiplinore ndaj tij duke e kthyer gjendjen e mëparshme gjegjësisht ankuesin ta kthej në vendin e punës Zyrtar Ligjor. Ndërsa po ashtu me date 21.09.2022 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net ankuesi thekson se „Qëndroj pranë kësaj ankese d.m.th me date 21.08.2022 unë kinse kam pranuar një vendin nga komisioni disiplinor, andaj komisioni përsëri me te gjitha gjasat me ka largu nga marrëdhënia e punës për çka brenda afatit ligjor ushtroj po ushtroj ankese“.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 30.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 12.10.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 6112/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndë si dhe 03.11.2022 ka përcjellë prova shtese.

Me datë 03.11.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr. 139/2022 për vazhdimin e afatit të ankesës Anr.815/2022 me numër të protokollit 5575/2022 të datës 21.09.2022, për ankuesin

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5575/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, përmes E-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Letër rekomandimi i datës 10.06.2015 për doktoratë e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinë të bashkangjitur me Letër vlerësimi dhe referim për [redacted] nga z. [redacted] Letër përshkruese për ankuesi nga znj. [redacted] Letër Vlerësues i Drejtorit të Shkollës "Mazllum Këpuska", Letër Motivuese për ankuesin nga

Gjimnazi "Hajdar Dushi", Letër reference e datës 24.08.2016; Referencë e datës 09.10.2016 nga Universiteti "Hasan Prishtina", në Prishtinë; Letër reference lëshuar nga "Banka Procredit" dega në Gjakovë; Letër referencë e vitit 2014; Kërkesën për plotësim e vendeve të punës për bashkëpunëtor profesionali datës 22.11.2016; Letër reference për ankuesin pa datë, nga Prokurori z Letër referuese e datës 05.04.2017 për ankuesin nga Prokuroria Themelore në Gjakovë; Kërkesë e datës 18.12.2017; Letër referencë e datës 08.02.2018; Letër rekomandimi - vlerësim pa datë, Prokuroria e Themelore në Gjakovë; Letër rekomandimi -vlerësim e datës 14.04.2017 nga Prokuroria e Themelore në Gjakovë; Letër rekomandimi nga Avokati për ankuesin pa datë; Letër rekomandimi e datës 15.03.2018 Prokuroria e Themelore në Gjakovë; Letër Referuese për ankuesin nga avokatja, pa datë; fotografi të nxjerra nga telefoni mobil prej ½ faqe; Letër rekomandimi për ankuesin nga avokati me datë 28.04.2016; Procesverbal i datës 16.02.2018 nga Prokuroria e shtetit prej ¼ faqe; fotografi të nxjerra nga telefoni mobil,(policia Gjilan); Përgjigje në ankesë e datës 12.10.2022 me numër protokolli 6112/2022; Vendim KD:Nr.02/2018 i datës 08.06.2018 nga Komisioni Disiplinor; Akt emërim i datës 08.10.2014; Akt emërim i datës 08.10.2015; Thirrje për paraqitje e datës 06.06.2018 nga Komisionin disiplinor S/KPK-së; E-mail i datës 08.06.2018 nga znj. për ankuesin, njoftim për vendimin e Komisionit disiplinor; Akt Dorëheqje e datës 18.12.2018, Kërkese e datës 31.10.2022 për mes E-mailit drejtuar Njësia e personelit të S/KPK-së; Përgjigje për mes E-mailit të datës 03.11.2022 nga Njësia e personelit të S/KPK-së; Vendimi KD:Nr.04/2022 i datës 10.08.2022 i Komisionit Disiplinor; Vendimi VK.NR.139/2022 i datës 03.11.2022 për vazhdim të afatit nga Kryetari i Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.815/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka qenë i sistemuar në pozitën "Zyrtar Ligjor" në Prokurorinë Themelore në Gjakovë-Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas Akt-it të emërimit me numër protokolli ZBNJ/DP-488/2015 të datës 08.10.2015, ndërsa Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pas shqyrtimit të kërkesës për iniciimin të procedurës disiplinore me datë 08.06.2018 ka marr Vendim me numër KD.nr.02/2018 me të cilin ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke shqiptuar masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës, pa i dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension" sipas nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimit me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor të Sekretariati të Këshillit Prokurorial të Kosovës, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin e datës 15.10.2018 e aprovon pjesërisht si të bazuar ankesën e datës 17.08.2018 të ankuesit duke shfuqizuar Vendimin KA.Nr.49/2018 e datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimin me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës i pa kënaqur me Vendimin e datës 15.10.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës



ka parashtruar kërkesë padi në Gjykatë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 14.04.2021 nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2527/2018, me të cilin e refuzon kërkesë padinë e paditësit Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe e vërteton Vendimin me numër A.nr.535/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli Prokurorial i Kosovës i pa kënaqur me Aktgjykimin Anr.2527/2018 e Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 18.05.2021 parashtron ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me datë 31.05.2022 nxjerr Aktgjykim me numër AA.nr.503/2021 me të cilin e aprovon si të bazuar ankesën e Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 18.05.2021 dhe anulon Aktgjykimin e datës 14.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative si dhe Vendimin me numër A.nr.535/2018 të datës 15.10.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e kthehen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas Aktgjykimit AA.Nr.503/2021 të datës 31.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, pasi ka rishqyrtuar provat e lëndës me datë 13.07.2022 merr Vendim me numër A.nr.528/2022, me të cilin vendim e ka aprovuar si të bazuar ankesën me numër A.nr.535/2018 të datës 17.08.2018, duke anuluar Vendimin KA.Nr.49/2018 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimin me numër KD.nr.02/2018 të datës 08.06.2018 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe çështjen e kthehen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës duke vepruar sipas Vendimit me numër A.nr.528/2022 të datës 13.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.08.2022 merr Vendim me numër KD.Nr.04/2022, me të cilin vendim Komisioni Disiplinor shpallet jo kompetent për vendosje në procedure disiplinore ndaj ish „Zyrtar Ligjor“ në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës konstaton se organi i punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës përmes përgjigjes në ankesë ka njoftuar respektivisht ka ofruar si dëshmi në Këshill shkresën respektivisht Aktin e dorëheqjes së ankuesit me numër protokolli 2011 të datës 18.12.2018. Kolegji sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas shkresës me numër protokolli 2011 të datës 18.12.2018 ka dhënë dorëheqje nga pozita e punës „Zyrtar Ligjor“ në Prokurorinë Themelore në Gjakovë-Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, dhe duke marr parasysh dispozitat ligjore të aplikueshme për nëpunësit e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, konstaton se sipas nenit 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“Nëpunësit civilë, në çdo kohë, mund të japin dorëheqje nga shërbimi civil pas dorëzimit të një njoftimi për dorëheqje mbikëqyrësit të tyre dhe udhëheqësit të organit përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës”*, si rezultat i kësaj Kolegji, konstaton se në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 dhe 2 i këtij ligji kanë përcaktuar se: *“1. Ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, me vendim të*

njëanshëm bëhet kur institucioni ose nëpunësi civil merr iniciativë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. 2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil ndërpritet me vendim të njëanshëm në rast të: 2.1. dorëheqjes dhe shkarkimit nga shërbimi civil për arsyet e parapara me këtë ligj”, rrjedhimisht ankuesi meqenëse ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij ende pa u ekzekutuar Vendimi me numër KD.nr.02/2018 i datës 08.06.2018 i Komisionit Disiplinor të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në këtë moment ka humbur statusin e nëpunësit civil.

Bazuar në këtë si dhe duke marr parasysh kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të përcaktuar me dispozitat nenit 6 paragrafit 1 nen paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “ 1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil”, ka kompetencë të shqyrtoj ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil”, Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe të kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.815/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.